

KOMENTIM I SURES IBRAHIM

Me emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

“Ibrahim” quhet surja e katërmbëdhjetë e Kur’anit dhe ka 52 ajete. Ajo i është shpallur Profetit Muhammed (paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të!) në Mekë.

Emri i profetit Ibrahim përmendet në ajetin e tridhjetepeshtë të kësaj sureje. Kjo nuk është e vetmja arsye që kjo sure emërtohet me këtë emër, sepse përveç emrit të tij përmenden edhe çështje me rëndësi që kanë lidhje me këtë profet. Emri i Profetit Ibrahim (paqja e All’llahut qoftë mbi të!) përmendet edhe në sure të tjera të Kur’anit. Edhe pse All’llahu e përmend shumë në Kur’an këtë profet, kjo është e vetmja sure e emërtuar me emrin e tij.

Jeta e profetit Ibrahim (paqja qoftë mbi të!) ka qenë e veçantë përse i përket njohjes së All’llahut dhe udhëzimit të të tjerëve në njohjen e Tij. Kjo metodë udhëzimi ka qenë e posaçme vetëm për të. Për ta lartësuar më shumë pozitën e tij, All’llahu i Madhëruar e sprovoi me sprovë të vështira. Ato janë të mbushura me mësim e këshilla. Nga këto mësim dhe këshilla kuptojmë se përse hazreti Ibrahim është shembull për jetën tonë.

Hazreti Ibrahim (paqja e All’llahut qoftë mbi të!) është prej profetëve të Vendosmërisë së Lartë (*Ulul Azmi*), të cilët kanë qenë të palëkundshëm në misionin e tyre. Ata janë përpjekur shumë për udhëzimin e njerëzimit. Sheriati dhe thirrja e tyre ka qenë e përgjithshme dhe jo e posaçme për një vend a për një kohë të caktuar. Për këto arsye është e këshillueshme të lexohet historia e jetës së këtij robi të All’llahut, e mbushur me ndodhira dhe ngjarje të ndryshme.

Ajo që do të paraqes në këtë shkrim ka të bëjë me njohuritë dhe hulumtimet e vyera që përmban surja Ibrahim. Jam mbështetur në kuptimin e jashtëm të ajeteve të kësaj sureje. Për nxjerrjen e këtyre njohurive nga ajetet jam mbështetur edhe në aspektin logjik. Mirëpo, kjo nuk do të thotë që nuk kam përdorur transmetime të ardhura për këtë sure. Po ashtu, këto njohuri që po paraqes, nuk mëtoj (pretendoj) se janë të prera e të pakontestueshme dhe se duhet të pranohen të gjitha. Është vendi të thuhet se askush nuk mund ta paraqesë përmbajtjen e plotë të një ajeti të Kur’anit, sepse Kur’ani sa vjen e më shumë hulumtohet dhe zbulohen të vërtetat e tij. Përpjekja ime është hap i parë për të aktivizuar të menduarit dhe logjikën për të rrokur sa më mirë kuptimin e ajeteve dhe për të gjetur rrugën e udhëzimit. Dihet që njeriu mund të gabojë në çështje të ndryshme, qoftë edhe në ato shkencore. Ajo që është më e rëndësishmja: ne duhet ta respektojmë mendimin e njëri-tjetrit. Përndryshe, do të jetë imponim mendimi, ngurtësim mendor dhe mendim i kufizuar.

Duke pasur parasysh kufizimin, do të përmend disa çështje prej çështjeve të kësaj sureje, si dhe ajetet që kanë një temë të përsëritur i kam përmendur të grupuara. All’llahu na mundësoftë në kuptimin e fjalëve të Tij.

Mësimet në grupin e ajeteve 1 – 3

1- Shkronjat e veçuara

Surja “Ibrahim” është një prej 29 sureve që fillojnë me shkronja të veçuara. Në shumicën e këtyre sureve, menjëherë pas shkronjave të veçuara përmendet Kur’ani. Kjo është një lloj sfide që Kur’ani me gjithë madhësinë dhe përmbajtjen e thellë, është i përbërë nga këto shkronja të alfabetit të gjuhës arabe. Sfida konsiston në kontekstin: nëse nuk e pranoni që Kur’ani është mrekulli, atëherë sillni një të njëjtë si ai. Dua të përmend diçka interesante. Nëse nuk i përmendim shkronjat e përsëritura në 29 suret që fillojnë me shkronja të veçuara, numri i shkronjave do të mbetet 14. Pra, do të vërejmë se nuk janë të gjitha shkronjat e alfabetit arab, por janë gjysma e tyre. Ka mundësi që qëllimi në këtë pikë është se gjysma e mrekullisë së Kur’anit ka të bëjë me frazat (*elfadh*) dhe gjysma tjetër ka të bëjë me kuptimet (*me’anij*).

2- Profeti i Islamit është ftues dhe ndërmjetësues për udhëzimin e njerëzve me lejen e All’llahut

Ajeti i parë i kësaj sureje thotë: **“Elif Lãm Râ. Këtë Libër ta kemi shpallur ty (o Muhamed), për t’i nxjerrë njerëzit, me lejen e Zotit të tyre, nga errësitat (e idhujtarisë, padrejtësisë dhe tiranisë) në dritë (besim, drejtësi dhe pajtim), në rrugën e të Plotfuqishmit, të të Denjit për çdo lavd.”**

Këtu shtrohet pyetja:

All’llahu i Madhëruar në disa ajete, siç është ajeti 213 i sures “Bekare”, thotë se Ai është Udhëzuesi: **“...Allahu shpie në udhë të drejtë kë të dojë.”** Në një ajet tjetër në Kur’an, siç është ajeti 185 i sures “Bekare” thuhet se Kur’ani është udhëzues për mbarë njerëzimin: **“Muaji i Ramazanit është ai, në të cilin ka zbritur Kur’ani, që është udhërrëfyes për njerëzit”**. Po ashtu, ka ajete të tjera që thonë se Kur’ani është udhëzues për mbarë njerëzimin. Mirëpo, ajeti i kësaj sureje na thotë se udhëzimi arrihet me ndërmjetësinë e Profetit Muhammed (paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të!).

Pyetje: Cili është qëllimi në këto thënie? Kush e udhëzon njeriun në rrugën e drejtë: All’llahu, Kur’ani apo Profeti?

Përgjigje: Te thënie e lartpërmendura nuk ka kundërshtime mes ajeteve. Udhëzimi është një, qoftë nga All’llahu, nga Kur’ani apo nga Profeti; drejt një rruge ftojnë. Për shembull, All’llahu në disa vende në Kur’an thotë që **Unë i marr shpirtat**, siç është ajeti 42 i sures “Zumer” ku thotë: **“Allahu ua merr shpirtat atyre që u ka ardhur çasti i vdekjes...”** Në një ajet tjetër thotë se Meleku i Vdekjes ua merr shpirtat njerëzve, siç thuhet në ajetin 11 të sures “Sexhde”: **“Thuaju: ‘Shpirtin do t’jua marrë Engjëlli i Vdekjes, i cili është caktuar për ju...”** ndërsa në ajetin 32 të sures “Nahl” thuhet se melekët ua marrin shpirtat njerëzve: **“...të cilëve engjëjt ua marrin shpirtat, duke qenë të pastër...”**.

Meleku i Vdekjes dhe melekët janë mjete nga ana e All’llahut që t’ua marrin shpirtat njerëzve.

Kjo do të thotë se melekët nuk janë të pavarur në veprimin e tyre. Çdo gjë e bëjnë me lejen e All’llahut të Madhëruar. Edhe Profetët i paraqisnin mrekullitë e tyre me lejen e All’llahut. Për shembull, Profeti Isa i ringjallte të vdekurit me lejen e All’llahut, siç thuhet në ajetin 110 të sures “Maide”: **“...se si me vullnetin Tim i ngjallje të vdekurit...”**

Përsa i përket udhëzimit, Kur'anit është i Libri i fundit, më i ploti dhe më i larti udhëzues për njerëzit dhe xhindet. Mirëpo, shpjegimin duhet ta marrim nga Vula e të Dërguarve, Profeti Muhammed, i biri i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!).

Për ta ilustruar mendimin po paraqes dy shembuj:

Së pari: Në një natë të kthjellët, kushdo që shikon qiellin do të shohë yje të ndryshëm. Në bazë të dijes që ka, çdo njeri arrin t'i kuptojë ato yje. Ndryshe ndodh me një astronom, i cili ka dije të shumta rreth yjeve dhe planeteve. All'illahu e ka hapur për ne faqen e Gjithësisë, por astronomi mund të jetë udhëzues dhe sqarues i të tjerëve rreth njohurive të Galaktikës.

Së dyti: Kur shohim një det apo oqean të gjerë e të thellë, e shohim me shikim sipërfaqësor. Kurse dijetari i ekosistemit të ujërave e sheh nga një tjetër këndvështrim. Ai ka njohuri edhe për përmbajtjen e brendshme të detit apo oqeanit dhe me dijen që ka ua sqaron njerëzve të vërtetën e detit dhe të oqeanit. Këta dy shembuj janë të thjeshtë dhe mund të konsiderohen shembuj materialë.

Kur mendojmë se dijen (Kur'anin) All'illahu ia dha krijesës më të përkryer, Profetit Muhammed, atëherë kuptojmë edhe kuptimin e ajetit të lartpërmendur që All'illahu ia shpalli Kur'anin atij që t'i udhëzonte njerëzit në rrugën e drejtë. Nga këtu kuptohet se dija e Profetit rreth Kur'anit nuk është si dija e njerëzve të tjerë të cilët e fitojnë atë duke e kërkuar. Dija e tij është dhunti, që do të thotë se ai nuk e ka fituar dijen nga dora e njerëzve dijetarë, por dija e tij është nga ana e Allahut të Gjithëditur.

3- Errësitat dhe drita

Ajo që tërheq vëmendjen në këtë ajet është se “errësitat” përmenden në numrin shumë, ndërsa “drita” në numrin njëjës. Kjo tregon se të gjitha virtytet e mira, si besimi, devotshmëria, etj., unifikohen në një bosht të vetëm, që është drita. Të gjitha këto virtyte janë faktorë të krijimit të një shoqërie të bashkuar e të ndritshme, ndërsa errësitat në çdo kohë dhe në çdo vend sjellin veçse përçarje, ndarje dhe shkatërrim.

4- Tri karakteristika të jobsimtarëve

✓ Të anuarit kah kjo jetë më shumë se kah Jeta Tjetër

2- Pengimi i njerëzve për në rrugën e Allahut

3- Përtpjekja për të shtrembëruar rrugën e drejtë dhe të vërtetë

Mësimet në grupin e ajeteve 4 – 20

Në këtë grup ajetesh gjenden këto mësimet:

1) Të përbashkëtat e profetëve në thirrje

1. Në fillim të misionit, të gjithë profetët janë dërguar me gjuhën e popullit të tyre, sepse qëllimi ka qenë që t'ua sqaronin më mirë njerëzve të vërtetën, rrugën e udhëzimit dhe të humbjes.

3. Të gjithë profetët janë dërguar që ta shpëtonin njeriun nga adhurimi i krijesave dhe ta drejtonin atë në adhurimin e Krijuesit (All'Ilahut).
4. Janë dërguar për të përmendur mirësitë e All'Ilahut dhe ditët e rëndësishme të Tij.
5. T'u kujtojnë njerëzve se nëse e falënderojnë All'Ilahun, ua shton mirësitë. Nëse e mohojnë, mirësitë zhduken.
6. Çdokush që i ndjek profetët, është i udhëzuar dhe i shpëtuar dhe kushdo që i kundërshton ata është i humbur.
7. Kundërshtimi i fjalës së profetëve nga njerëzit. Për këtë, njerëzit shfaqnin mosbindje, dyshim në fjalët e profetëve.
8. Jobsimtarët i ofendonin dhe i keqtrajtonin profetët, por profetët i prisnin me durim dhe me zemërgjerësi këto ofendime dhe keqtrajttime dhe ishin të mbështetur tek All'Ilahu.
9. Lutja e profetëve gjithmonë ishte që All'Ilahu të triumfonte mbi jobsimtarët.
10. All'Ilahu u premton profetëve se do të trashëgojnë Tokën, siç thotë ajeti i 14 i kësaj sureje. Në vende të tjera në Kur'an, All'Ilahu u premton besimtarëve se ata do të jenë trashëgues të Tokës, siç thotë ajeti 5 i sures "Kasas" dhe ajeti 105 i sures "Enbija".

2) *Argumentet e jobsimtarëve për mospranimin e thirrjes së profetëve*

1. Profetët ishin prej njerëzve

Ishte dëshira e All'Ilahut që të dërguarit të ishin nga njerëzit. Por, të padrejët dhe mendjemëdhentë nuk e pranorin këtë. Ata nuk donin që të dërguarit të ishin prej njerëzve. Në ajetin 9 të sures "En'am", thuhet: **“Edhe sikur Ne ta bënim atë (Muhamedin) engjëll, me siguri që do t'i jepnim atij pamje njeriu dhe, kështu, do të bënim që të ngatërroheshin në lidhje me mesazhin, për të cilin tashmë ata janë të ngatërruar.”** Të qenit e profetëve prej njerëzve është mirësi e madhe e All'Ilahut. Duhet të dihet se edhe ato të veçanta që kanë melekët, ato janë nga All'Ilahu i Madhëruar. Ashtu siç u ka dhënë melekëve pozitë të lartë, po ashtu, All'Ilahu u jep edhe njerëzve të zgjedhur të Tij pozitë të lartë.

Cila është urtësia që i dërguari duhet patjetër të jetë prej njerëzve?

Së pari: Zanafilla e udhëzimit dhe e humbjes fillojnë këtu. Nëse njeriu e mposht mendjemadhësinë dhe egon është i shpëtuar, dhe do të jetë nën kujdestarinë e të dashurve të All'Ilahut. Nëse njeriu vazhdon të jetë mendjemadh si djalli që refuzoi sexhden për Ademin, ai do të jetë larg mëshirës së All'Ilahut.

Së dyti: Të dërguarit e All'Ilahut janë shembulli më i mirë. Për këtë, ata duhet të jenë prej njerëzve që të jenë argument për të tjerët. All'Ilahu ka vendosur te profetët edhe epshe, por ata i kontrollojnë ato. Për këtë arsye, ata janë argument i qartë për të tjerët. Edhe të tjerët duhet ta kontrollojnë veten e tyre dhe të mos bien në rrugën e gabuar.

2. Imitimi i verbër i traditave dhe besimeve të kota të baballarëve

Rreth baballarëve, Kur'ani flet logjikisht dhe e nxit njeriun të mendojë. Kur'ani thotë: Nëse baballarët kanë qenë të gabuar, atëherë edhe ju doni të ecni në atë gabim?! Përse nuk mendoni? Përse nuk përfitoni nga mendjet tuaja?

3. Kërkesa për të sjellë mrekulli apo argument sqarues për të qënit Profet

Në disa ajete thuhet se jobesimtarët e caktuan se çfarë mrekullie donin. Mirëpo, pasi e panë atë që kërkuan, përsëri nuk besuan. Ata e quanin mrekullinë, magji dhe profetët magjistarë. Historia dëshmon se këta lloj njerëzish nuk donin të udhëzoheshin. Ata ishin kundërshtarë dhe ofendues të profetëve.

3) *Kërcënimet e mohuesve për profetët*

Kërcënimi për nxjerrjen nga vendi i banimit ose kërcënimi për të ndjekur rrugën e tyre.

4) *Fundi i jobesimtarëve*

Shkatërrim, hyrje në Zjarr (Xhehennem), ndëshkim i rëndë. Ata do të kenë një dënim që as nuk e përballojnë dhe as nuk mund të dalin prej venddënimit. Vdekja u vjen rrotull, por ata nuk vdesin. (ajeti 17)

5) *Hiri përballë erës*

Në disa raste, për t'u kuptuar më mirë çështja, Kur'ani sjell shembuj. Në ajetin 18 të kësaj sureje, punët e jobesimtarëve i shembëllen me hirin në një ditë me erë të fortë. Në këtë mënyrë, për jobesimtarët nuk mbetet asnjë lloj pune në dorën e tyre. Të gjitha punët e tyre janë të pavlera dhe të zhdukura. Përse është përmendur ky shembëllim? Kjo sepse:

- 1- Hiri është i pavlerë, të tilla janë edhe punët e tyre.
- 2- Sekret i është se ajo punë që nuk është për hir të All'llahut është si hiri i cili nuk është i pvllefshshëm. Një herë të fryjë erë, ai zhduket.
- 3- Është dhënë ky shembull që të tregojë se punët e këtyre jobesimtarëve do të digjen dhe prej tyre nuk mbetet veçse hiri, siç thuhet edhe në ajetin 217 të sures "Bekare".

6) *Një shenjë e fuqisë së All'llahut*

Nëse do All'llahu e zhduk një popull dhe sjell një popull tjetër. Në të vërtetë, ky është një kërcënim për mohuesit e së vërtetës dhe mendjemëdhenjtë. Ndërsa, për profetët dhe besimtarët e drejtë nuk është kërcënim sepse ata e njohin shumë mirë fuqinë e All'llahut.

Mësimet në grupin e ajeteve 21 – 34

1) *Kiameti dhe pjesë e dialogjeve në atë ditë*

- 1- Biseda e ndjekësve injorantë me të parët e tyre mendjemëdhenj për të marrë një pjesë të dënimit të tyre. Mirëpo kjo bisedë është e pavlerë dhe të dy grupet ndëshkohen.

2- Djalli është vetëm thirrës.

Kjo është thënie e djallit për ndjekësit e tij. U thotë: Unë nuk kam patur sundim mbi ju; unë ju ftova dhe ju ishit ata që e pranuat ftesën time. Mos më fajësoni mua, por fajësoni veten tuaj.

3- Dialogu i banorëve të Xhennetit të përqendruar në paqe dhe në pastërti. Fjala më e mirë e tyre me njëri-tjetrin është fjala “Selam”.

2) *Dy shembuj, për dy grupet: të vërtetën dhe të pavërtetën*

1- Fjala e mirë, biseda e mirë, e pastër, është përngjarë me pemën e mirë, e cila rrënjët i ka në tokë dhe degët e saj të larta në qiell.

2- Përballë shembullit të parë, fjala e keqe dhe thënia e keqe janë përngjarë me pemën e keqe. Rrënjët i ka të cekëta (mbi tokë) dhe nuk është e bazuar dhe as e qëndrueshme.

Pyetje: Përse All’llahu ka zgjedhur fjalën si shembull dhe jo punën? Çfarë rëndësie ka fjala?

Fjalët dhe të folurit sqarojnë mendimet, ndërsa mendimet janë lëvizëse të veprave. Fjala dhe të folurit janë rrugët më të mira për predikim dhe për dialog. Tek fjala duket më qartë e drejta dhe e padrejta. Përderisa janë të tilla, ato janë sjellë si shembuj. Edhe Kur’ani, mrekullia e përjetshme e profetit Muhammed, është i përbërë nga fjalët dhe thëniet. Ka mundësi që *fjala e mirë* ka kuptimin e Kur’anit.

3) *Mendimet e të tjera rreth kuptimit të fjalës së mirë*

1- Fjala e teuhidit, fjala “La ilahe il-lall-llah”

2- Besimi, që është kuptimi dhe përmbajtja e teuhidit.

3- Besimtari i drejtë. Këto nuk mohojnë njëra-tjetrën. Ato mund të jenë të përbashkëta.

4) *Çdo ekzistencë dhe krijesë mund të jetë fjalë e All’llahut*

Përderisa fjala dhe thënia janë shenjë e folësit, edhe krijesat dhe ekzistenca mund të jenë fjalë e All’llahut, sepse çdo krijesë ka potencial që të jetë shenjë e fuqisë së përhershme të All’llahut. Ndër krijesat e Tij, All’llahu ka krijuar nga më e vogla (merimanga) e deri te më e madhja, elefanti. Në të gjitha krijesat vendosi sistemin e domosdoshëm për të gjithë për vazhdimin e jetës: sistemin e qarkullimit të gjakut, stomakut, sistemin e shpërndarjes së lëndëve ushqyese në trup, rritjen dhe zhvillimin, shumimin e deri te sistemi nervor, ndjeshmëria dhe ai i vetmbrojtjes nga sëmundjet e me qindra sisteme, të cilat disa njihen e disa nuk njihen. Këto sisteme janë të nevojshme për vazhdimin e jetës. Krijesat ndryshojnë sipas ambientit dhe territorit gjeografik në këtë botë. Ky ndryshim është i bazuar në dije dhe urtësi.

5) *Njeriu, lulja më e bukur e krijimit*

Njeriu me pozitën që ka në krijim është argument i thënies: “I Lartësuar është All’llahu, Krijuesi më i Përkryer”. Ai ka vendin më të lartë, më të fortë ndër të gjitha krijesat dhe është më i ndërlikuari i tyre. Njeriu, nëse e kupton pozitën e tij dhe është mirënjohës i kësaj mirësie dhe është punëmirë para All’llahut, mund të shndërrohet në një njeri që të jetë shembull për të tjerët. Po ashtu, është model i

robit të afërt tek All'llahu. Përndryshe, dita-ditës, ai arrin postin e të këqinjve. Imam Aliu, në vargjet e një poeme i drejtohet njeriut që të hedhë vështrimin nga vetja e vet.

A e quan veten krijesë të vogël

E te ti shpaloset bota e madhe?!

Kuptimi: Ti e quan veten të vogël, mirëpo në ekzistencën tënde të shpaloset gjithësia e gjerë. Sikur njeriu ta dinte vlerën e tij, do ta kuptonte madhësitinë e Krijuesit. Ai përpiqet ta adhurojë më shumë All'llahun. Përballë madhësisë së All'llahut përulet. Ai ka mundësi të jetë vërtetësi e *fjalës së mirë* dhe të zhvillohet më shumë se *pema e gjelbër e frytdhënëse*, degët e së cilës arrijnë në qiell dhe japin frutin në çdo kohë që dëshiron All'llahu. Ata njerëz që strehohen në këtë pemë, fitojnë edhe hijen e freskët, si dhe kënaqësinë e frutave të shijshme. Nëse janë mosmirënjohës, ndjekin rrugën e padrejtë, të mohimit, mosmirënjohjes dhe ndjekin epshin dhe djallin: këto janë shembuj vërtetues të *pemës së keqe*. Ata janë si pema e parrënjë, e cila në çdo moment përballet me zhdukjen. Askush nuk mbështetet e strehohet në të.

6) *Fundi i mohuesve të mirësive të All'llahut është Xhehennemi*

7) *Ata që i vendosin shok All'llahut për të devijuar njerëzit nga rruga e All'llahut janë në Xhehennem*

Çfarë dobie kanë mohuesit kur ftojnë të tjerët në mohim?

Që herët, paria e shirkut dhe kufrit, kur i bënin shirk All'llahut, nuk ishte se vepronin vetëm duke prodhuar idhuj materialë, por shkonin edhe më gjerë duke fantazuar zota imagjinarë. Ata përpiqeshin t'i largonin njerëzit nga mësimet dhe orientimet e profetëve dhe i shfrytëzonin njerëzit për interesat e tyre. Profetët janë të dërguarit e All'llahut që erdhën të mësonin njerëzve lirinë. Ata përpiqeshin ta zbkuronin njeriun me kurorën "*Vërtet, Ne e kemi nderuar birin e Ademit (njeriun)*", që njeriu të krenohet me të. Ata i porositnin njerëzit që të jenë robër të All'llahut. Mirëpo njeriu me cilësi shejtani, për sigurimin e interesit të tij në këtë jetë, shfrytëzon njeriun. Ata i përfytyronin shok All'llahut në fuqi dhe çdo gjë që hamendësonin e cilësonin zot. Me këto hamendësi depërtonin në mesin e të paditurve dhe përfitonin shumë prej tyre. P.sh. ata bënin kurban për ata zota, ose jepnin një pjesë të prodhimit vjetor nga të mbjellat, luftonin për mbrojtjen e udhëheqësve të tyre. Në këtë mënyrë, ata përfitonin nga pasuritë dhe shpirtrat e njerëzve për hir të interesit të vet. Ata, të mirët ose i burgosnin ose i vrisnin. Sot në tregun e dynjasë kemi një shirk më të ndërlikuar. Me mashtrimet moderne, i largojnë njerëzit nga rruga e drejtë. Në vend të bagëtive dhe të mbjellave, sot po i vidhet çdo gjë njeriut, deri edhe të menduarit dhe njohuritë e tij.

8) *Namazi dhe shpenzimi janë përmendur në një rresht*

Namazi që është punë adhurimi dhe e drejtë e All'llahut, është përmendur së bashku me shpenzimin. Kjo është shenjë se përkrahja e të tjerëve është shumë e rëndësishme. Robi i All'llahut duhet të mendojë edhe për njerëzit e tjerë. Në ajete të tjera të Kur'anit lexojmë se hyrja në Xhehennem ka dy shkaqe: nuk kanë qenë prej falësve të namazit dhe as nuk kanë ushqyer të mjerët. Adhurimi e bën

njeriun të mos jetë kryelartë. Ky adhurim duhet të nxitë në shërbim të krijesave me nijet të pastër, plotësohet dhe merr vlera të shumta.

9) *Me vendosjen e ligjeve, All'llahu çdo gjë e ka vendosur në shërbim të njeriut*

P.sh. ligji i lidhjes së molekulave, pesha e veçantë e çdo elementi, e të tjera ligje sunduese për natyrën, këto tregojnë se kur njeriu përfiton nga këto ligje dhe nga të veçantat e materies, ai mund të ndërtojë anije me tonazh të madh prej hekuri që lundrojnë mbi ujin e rrjedhshëm. Kjo është e mundur për çdo kohë e për çdo vend. Në këtë mënyrë realizohet dëshira e All'llahut që me vendosjen e ligjeve dhe krijimin e materies e të elementeve së bashku me të veçantat e saj, bëhen shkak për zbulimin e informacionit e të shkaqeve. Pas njohjes së këtyre, ai duhet të lëvizë në rrugën e drejtë e të kënaqësisë së All'llahut. Jo vetëm detin, oqeanet i ka vënë në dizpozicion për ne, por edhe diellin, hënën, natën dhe ditën.

10) *Çfarë ne duam, All'llahu na e ka dhënë*

Nëqoftëse në kohën e lutjes ne kërkojmë me gjithë zemër dhe kemi besim të plotë te All'llahu, nëse është në interesin tone, ajo arrin. Thënë ndryshe: çfarë ne duam, All'llahu na e ka dhënë më parë. Ai i ka vendosur të gjithë faktorët e duhur në dorë të njeriut. Më pas ka thënë: “Njeriu merr aq sa sakrifikon”. Nëse duam që të japë shëndet, Ai na ka dhënë. Mirëpo, me prishjen e faktorëve natyrorë dhe mosinteresimin për dobritë personale dhe shoqërore, ne i largojmë vetë shkaqet e shëndetit. All'llahu na ka dhënë mendje, njohje, faktorët e udhëzimit e të lumturisë dhe i ka vendosur në duart tona. Mirëpo duke ndjekur dëshirat dhe shejtanin, ne e çojmë veten tonë në humbje.

11) *Mirësitë materiale dhe shpirtërore të All'llahut janë shumë të gjera dhe askush nuk mund t'i numërojë*

Rezultati: Të gjitha krijesat, uji, toka, anija, dielli, hëna, nata, dita, etj... të gjitha janë vënë në dizpozicion të njeriut. Por është për të ardhur keq, se njeriu me largimin nga drita e besimit dhe e mësimëve të All'llahut, ka zgjedhur rrugën e padrejtësisë, tiranisë, për vete e për të tjerë, siç thuhet në ajetin 34 të kësaj surje: “*i padrejtë dhe mosmirënjohës*”. (Zoti na mbrojtë prej të tillëve!).

Mësimet në grupin e ajeteve 35 – 41

1) *Lutjet e hazreti Ibrahimit në këto ajete drejtuar All'llahut.*

O Zoti im!

1- Bëje Mekën vendsigurie!

2- Mua dhe pasardhësit e mi na largo nga adhurimi i idhujve!

3- Zemrat e njerëzve për familjen time drejtoji kah pasardhësit!

4- Furnizoji ata me frutat e këtij vendi!

5- Më bëj mua dhe pasardhësit e mi, prej falësve të namazit!

6- O Zoti im, pranoje lutjen time!

7- O Zoti im! Më fal mua dhe fali prindërit e mi dhe besimtarët në ditën që do të jepet llogari!

2) *Sa herë që të lutemi për vete, duhet të lutemi edhe për prindërit për familjendhe për besimtarët.*

3) *Lutjet e hazreti Ibrahimit u pranuan.*

4) Hazreti Ibrahim ka qenë i dashur dhe i mëshirshëm me të gjithë njerëzit.

Deri edhe për mëkatarët nuk bënte lutje për shkatërrim, por thonte: O Zot kush më kundërshton, Ti je i Mëshirshëm dhe Falës.

5) Gjurmët e shtëpisë së All'llahut gjendeshin para se të banonte Ismaili dhe nëna e tij Haxherja.

Pas një kohe, sipas ajetit 27 të sures "Bekare", hazreti Ibrahim me djalin e tij, Ismailin e rregulluan Shtëpinë e All'llahut, duke ngritur muret e saj.

6) Për hir të kënaqësisë së All'llahut, Ibrahim i vendosi të dashurit e tij, djalin dhe gruan, në vendin e thatë pa bimë e pa pemë.

7) Vendosja e tyre në këtë vend ka qenë që të falnin namazin.

Hazreti Ibrahim sikur e dinte se ky vend do të bëhej i përshtatshëm për jetesë dhe për adhurimin e Një Zoti të Vetëm e të Pashoq.

8) Si rezultat i sinqeritetit të kësaj familjeje, në atë tokë të shkretë e të thatë, buroi burimi i Zemzemit dhe u ndërtua Meka.

Sot, shohim me miliona myslimanë që mblidhen në shtëpinë e All'llahut duke kryer ritet e Haxhit. Po ashtu, në çdo ditë dhe në çdo vend, myslimanët drejtohen nga kjo shtëpi kur falin namaz.

9) All'llahu është i Gjithëditur për të dukshmen dhe të fshehtën.

10) All'llahu i dhuroi hazreti Ibrahimit dy djem kur ishte i thyer në moshë.

Kjo është shenjë se All'llahu është i Plotfuqishëm që të bëjë diçka që zakonisht mund të jetë e pamundur. Sipas disa transmetimeve, moshja e hazreti Ibrahimit kur lindi Ismaili ishte 99 vjeç. Dhe kur lindi Is'haku ishte 112 vjeç. Disa kanë thënë që ka qenë më i vogël. Sido që të jetë, ai ka qenë në moshë që zakonisht është e pamundur që të lindë fëmijë.

Mësimet në grupin e ajeteve 42 – 52

- 1) **Kiameti dhe dita e llogarisë do të vijnë.**
- 2) **Pamundësia e rikthimit nga ajo botë për të kompensuar punët e lëna.**
- 3) **Sa të jemi në këtë jetë të marrim mësim prej të padrejtëve dhe historisë së tyre.**
- 4) **Kurthet dhe intrigat e të padrejtëve, sado të mëdhaja të jenë, para dëshirës së All'llahut nuk janë asgjë.**
- 5) **All'llahu është shumë falës, por ndaj të padrejtëve është shumë i ashpër.**
- 6) **Të gjitha shembujt që përmenden në Kur'an janë mësim dhe konsideratë për të gjithë.**
- 7) **Disa pika rreth Kiametit:**
 - 1- Sytë, prej frikës dhe tmerrit, mbeten të hapur dhe të palëvizur.
 - 2- Qafat janë të zgjatura e të ngrira dhe koka do të jetë në qiell (Iart).
 - 3- Nga frika, zemrat dridhen derisa t'u duket se nuk kanë zemra.
 - 4- Të padrejtët kërkojnë afat të shkurtër për të plotësuar ato që nuk bënë kur ishin në këtë jetë. Por kjo kërkesë e tyre refuzohet.

- 5- Mohuesit dhe të padrejtët janë në mjerim dhe poshtërim të madh. Kjo sepse nuk morën mësim prej jetës së paraardhësve të tyre.
- 6- Në Kiamet, kjo Tokë do të ndryshohet në tokë tjetër, qielli në tjetër qiell. Kjo do t'i frikësojë më shumë njerëzit në atë ditë.
- 7- Kriminelët në atë ditë janë të lidhur me zinxhirë e pranga.
- 8- Rrobat e kriminelëve mëkatarë janë prej lënde ngjitëse, kanë erë të keqe dhe kanë aftësinë e ndezjes.
- 9- Fytyrat e kriminelëve do t'i djegë zjarri. Kjo është një pjesë e vogël prej dënimit të Ahiretit që i pret mëkatarët dhe kriminelët gjynahqarë. (I kërkojmë All'llahut mbrojtje prej dënimit në Ahiret dhe të mos i bëjmë padrejtësi as vetave tona e as të tjerëve!)

Përmendja e kësaj çështjeje është që të dimë se profetët e All'llahut kanë qenë përgëzues dhe qortues (paralajmërues). Sipas kësaj, besimtari duhet të ketë parasysh të dyja anët. Ashtu siç shpresojmë në mëshirën e All'llahut, duhet t'i frikësohemi edhe dënimit të Tij përshkak të punëve të veta. Askush të mos thotë se është i mbrojtur nga dënimi. Sipas thënieve të dijetarëve të moralit, besimtari për lartësimin e vetes, duhet ta vendosë veten mes frikës dhe shpresës. Pra, të sjellë para syve, Xhehennemin dhe Xhennetin. Të mos thotë se jam në këtë apo atë anë. Ai duhet të jetë i ekuilibruar. Gjithmonë të jetë zbatues i rregullave dhe i detyrave të ardhura nga All'llahu. Nëse i zbaton, do të jetë në Xhennet dhe nëse jo, do të jetë në Xhehennem. Shpresa e madhe e nxit njeriun që të bëjë gjynahe të mëdha. Ndërsa frika e madhe e bën njeriun të stresuar dhe të mërziur duke e prerë shpresën nga mëshira e All'llahut.

O Zot, na mbarëso në atë që Ti je i kënaqur!